
NDIKIMI I RENTËS MINERARE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

Bedri Statovci

Universiteti “Haxhi Zeka”, Kosovë, bedri.statovci@unhz.eu

Vlora Berisha

Universiteti “Haxhi Zeka”, Kosovë, vlora.berisha@unhz.eu

Abstrakti

Për të eliminuar varfërinë e tmerrshme, për të sendërtuar çdo lloj përparimi në Kosovë, pikësëpari duhej reformuar sistemi financiar i shtetit në një mënyrë të tillë që të hyrat të zhvillohen shkallë – shkallë, sa që t’ju bëjnë balle të gjithave nevojave, që lyp një qytetërim i lartë.

Sfidë për të gjitha qeveritë e botes është se si të bëhet mbledhja e të hyrave publike dhe zgjedhja e formave të mbledhjes së të hyrave publike, me qëllim të mbushjes së buxhetit shtetrorë.

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i rentës minerare apo siç përdoret edhe me emrin *tantiema*, e cila është një e hyrë publike apo shtetërore me mjaft ndikim në buxhetin e shteteve.

Fjalët e rëndësishme: Renta minerare, buxheti, të hyrat publike, instrumente financiare.

JEL Klasifikimi: H2, H6, H1, G2.

Hyrja

Në shumë vende të botes nxjerren burimet natyrore, renta minerare ka një rol të rëndësishëm si burim i të ardhurave të qeverisë. Duke pasur parasysh se mineralet në Kosovë janë pronë e shtetit, atëherë konsiderohet se renta minerare është një para e shtetit, përkatësisht përbën një para publike dhe duhet të jetë pjesë e buxhetit të pushtetit qendrorë lokal.

Renta Minerare (*tantiema*), paraqet paratë e paguara në intervale të rregullta nga operatori i minierës, pronarit të tokës (shtetit), bazuar në vlerën e

mineralit në “Mines Gate” (porta kryesore), (UMNIK, 2005).

Rëndësia e rentës minerare në kontrollin e investimeve në sektorin mineral është e madhe. Lartësinë e saj projektuesi duhet ta parashohë në Studimin e Fizibilitetit të kompanive, sepse kompania obligohet ta paguajë rentën minerare pa marrë parasysh gjendjen financiare të saj, apo pa marrë parasysh nëse ka krijuar profit apo jo.

Prandaj, si qellim i këtij punimi është trajtimi i rentes minerare në Kosovë dhe krahasimi i saj me disa vende të ndryshme të botës, legjislacioni që e rregullon rentën minerare, ndikimi i rentës minerare në buxhetin e shtetit të Kosovës, ndikimi i rentës minerare në zhvillimin ekonomik në Kosovë dhe politikat e qeverisë lidhur me rentën minerare.

Metodologjia e hulumtimit

Sa i përket aspektit metodologjik gjatë studimit të kësaj teme do të bazohemi në disa metoda të kërkimit dhe hulumtimit shkencor. Për të arritur objektivat e synuara do të përdorim disa metoda si: Metoda e Analizës duke përfshirë analizën e kërkimeve ekonomike, duke përfshirë Metodën e analizës Kuantitative, Kualitative, Makroekonomike dhe Mikroekonomike. Pasi që kemi të bëjmë edhe me rentën minerare si e hyrë publike në veçanti, atëherë e kemi përdorur edhe Metodën e Induksionit, ku nga hulumtimi i rentës minerare në veçanti, të nxjerrim konkludim edhe për llojet tjera të hyrave nga të cilat varet edhe buxheti shtetëror. Po ashtu gjatë këtij punimi shkencor do të zënë vend edhe metoda tjera hulumtuese si: Metoda e Gjeneralizimit, Specializimit, Konkretizimit, Metoda Empirike dhe metoda tjera hulumtuese shkencore.

Me anë të metodës së krahasimit e kemi bërë krahasimin e mesatares së rentës minerare në Kosovë dhe disa vende të ndryshme të botës, po ashtu edhe përcaktimin e rentës minerare në minerale të ndryshme.

Punimi gjithnjë do të mbështetet vetëm në të dhëna të bazuara, shkencore dhe konkrete.

Hipotezat dhe pyetjet kërkimore kanë të bëjnë me atë që bazuar në disa hulumtime dhe vlerësime, cili do të ishte ndikimi i rentës në buxhetin e Kosovës dhe cili do të ishte ndikimi i rentës minerare në zhvillimin ekonomik të vendit.

Përcaktimi i mostrës kërkimore paraqet një çështje që është veçanërisht e rëndësishme për hulumtime që kanë për qëllim të studiojnë fenomenin në popullimin e përgjithshëm apo në segmente të veçanta të saj.

Për të arritur rezultate sa më të sakta dhe për të përfituar njohuri, rreth rentës minerare, jem konsultura me disa zyrtarë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, si institucioni i autorizuar që menaxhon me sektorin mineral, si me

=====

gjeolog, inspektor dhe Divizionin e të Hyrave. Pastaj jem konsultuar dhe kem pasur takime me zyrtar të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, si pjesmarrës dhe hartues të strategjisë minerare, si dhe kam konsultuar me disa ekspertë të industrisë minerare.

Si mostër e arkëtimit të rentës minerare në Kosovë i kam përmendur Ndërmarrjen "Trepça", Ferronikelin, KEK-un dhe Sharr-Cem, të cilët janë përdoruesit apo shfrytëzuesit më të mëdhenjë të resurseve minerare, njëkohësisht, paguesit më të mëdhenjë të rentës minerare, po qe se do të paguanin ashtu siq duhet.

Rishikimi i literatures

Me rishikimin e literatures, vihet re që shumë studius nga vendet e ndryshme kanë trajtuar renten minerare.

Qeveritë realizojnë të ardhura nga burimet natyrale (naftë, qymyr, dhe metalet e tjera minerale) në disa forma të ndryshme legale dhe ekonomike. **(Baunsgaard, 2001)**, tregon përdorimin mbar botëror të formave të ndryshme të taksave të veçanta në këto aspekte.

(Land 2007), zhvillimi i sistemeve tatimore dhe konkurrenca e taksave në mes të vendeve nxjerrë në pah mungesën e një kornize teorike ose empirike mbi çështjen se si duhet të ndahet renta e burimeve minerale.

(Laporte & Quatrebarbes, 2008), në punimin e tyre "Çfarë dimë rreth shpërndarjes së rentes nga Burimet Minerare në Afrikë?", tregon që të hyrat nga tatimet minerare për qeverin Afrikane janë ritur me një faktor prej 1.57.

Po ashtu edhe një studius tjetër nga Afrika **(Campbell 2004)**, thekson se sektori minear i ketij vendi është i liberalizuar dhe vendet afrikane janë duke i zhvilluar sistemet e tyre tatimore për të tërhequr investitorë të huaj.

Në praktikën ndërkombëtare, siç mund të vërehet nga tabela më poshtë, renta minerare caktohet me përqindje për ato minerale të cilat janë të radhitura në tregjet botërore të bursave. Çmimi i taniemës ndryshon varësisht nga çmimi në bursa, ndërsa në shumica fikse caktohet zakonisht për ato minerale të cilat nuk gjenden në bursa, e për të cilat duhet të merren çmimet nga tregu i zakonshëm. Për shkak të vështirësive në përcjelljen e përditshme të çmimeve, si dhe për shkak të ndryshimeve të çmimit nga tregu në treg, atëherë renta minerare caktohet fikse.

Më poshtë kemi paraqitur edhe sqarime të llojeve të ndryshme të taniemave nga Uells i Ri Jugor i Australisë, të punuar në Qershor 2003 nga "Departamenti i URJ për Resurset Minerale", ku sqarohen disa lloje të rentave minerare.

(URJ, 2003), Renta Minerare në profit aplikohen vetëm te punët specifike minerare që gjenden në Broken Hill. Tantiema e profitit është kryesisht e ndryshme

=====

nga profiti i përbashkët apo taksa në profit. Dispozitat e shoqëruara me tantiemat në profit janë shumë komplekse për t'i diskutuar këtu, sidoqoftë, informatat e mëtutjeshme mund të sigurohen duke kontaktuar Degën e Rentës Minerare në kuadër të Departamentit.

Renta Minerare në Thëngjill - Renta Minerare vilet në gjithë thëngjillin e përmirësuar në Uellsin e Ri Jugor, dhe aplikohen tri lloje të tantiemave në thëngjill:

- Renta Minerare në tarifën bazë;
- Renta Minerare shtesë;
- Renta Minerare e zhvleftësuar e thëngjillit.

Renta Minerare (tantiema) e tarifës bazë - Tarifa bazë është \$1.70 për tonelatë, e pagueshme në muaj (me vonesë) për thëngjill të përmirësuar. Sidoqoftë, pagesa e rentës minerare shtyhet deri në atë kohë sa thëngjilli nuk hiqet ose derisa nuk shitet. Për qëllim të pagesës mujore të rentës minerare, tonazhi i thëngjillit zvogëlohet me një lagështi të lejuar. Minierat e thëngjillit në fushën jugore të thëngjillit i nënshtrohet një lagështie të lejuar prej 7 %, përderisa të gjitha fushat e tjera të thëngjillit i nënshtrohen një lagështie të lejuar prej 5.5 %.

Renta minerare shtesë - Disa miniera të thëngjillit, të shfrytëzuara përmes metodës të prerjes së hapur, tërheqin një rentë minerare shtesë me një tarifë prej 50 centë për tonelatë. Kjo rentë minerare i shtohet tarifës bazë të rentës minerare dhe llogaritet në bazë të njëjtë.

Renta minerare e zhvleftësuar e thëngjillit - Renta minerare është e pagueshme në thëngjill të zhvleftësuar nëse thëngjilli i zhvleftësuar përdoret ose largohet tutje për qëllim të prodhimit të energjisë. Thëngjilli i zhvleftësuar definohet si produkt i shfrytëzimit ose përpunimit të thëngjillit i cili ka vlerë energjetike prej më pak se 16 gigaxhulë për tonelatë të terur, ose që përmban më shumë se 35 % të hirit në peshë të terur. Tarifa e rentës minerare të thëngjillit në thëngjill të zhvleftësuar është 5 % e vlerës së ish-minierës deri në maksimum prej 85 centë për tonelatë (p.sh 50 % të tarifës bazë të rentës minerare).

(Otto, Craig, Fred, Doggett, & Pietro, 2006), Renta minerare e naftës - Aktualisht, Renta minerare është e pagueshme në tarifën prej 10 % të 'vlerës së naftës në vendburim (well head value).

Për titujt e dhënë ose të rinovuar pas datës 21 gusht 1992, sipas Aktit të Naftës (bregdet) të vitit 1991, tarifa e rentës minerare për pesë vitet e para të prodhimit komercial është zero, dhe për vitin e gjashtë 6 %, duke u rritur më 1% çdo vit, deri në 10% të vlerës well-head në vitin e dhjetë.

Në shembujt e mëposhtëm kam marrë disa nga metalet që janë më karakteristike, shumica e të cilave gjenden edhe në Kosovë. Janë marrë shembuj të

=====

disa shteteve të cilat zhvillimin kryesor të tyre e kanë të bazuar në eksploatimin e mineraleve.

Nga përvojat ndërkombëtare mund të vërehet se kriteret për caktimin e rentës minerare dallojnë nga vendi në vend, po ashtu dallon edhe lartësia e rentës minerare që duhet paguar për mineralet e caktuara. Për shembull, vendet që kanë monopol në tregun botëror për ndonjë mineral caktojnë renta minerare më të larta. Edhe disa vende që dëshirojnë ta kufizojnë shfrytëzimin e ndonjë minerali caktojnë rentë minerare të lartë, ndërsa disa vende që dëshirojnë të tërheqin investime në miniera dhe përfitimet e veta i arrijnë përmes taksave tjera dhe përmes partneritetit publik privat, aplikojnë shkallë më të ulët të rentës minerare.

Vendet e ndryshme aplikojnë edhe shkallë të ndryshme të rentës minerare për mineralin e njëjtë në vendin e njëjtë. Do ta marr si shembull Afrikën e Jugut.

(Otto, 2006), Përdorimi i sistemit të shumëllojshëm (multi-tier) të rentës minerare:

- Koncentratet (Afrika e Jugut = 4 %)
- Produkte finale (Afrika e Jugut = 2 %)
- Eksporti (Afrika e Jugut për qymyr = 3 %)
- Domestik përdorimi në vend (Afrika e Jugut për qymyr = 1%)

Nga ky shembull shihet se me anë të rentës minerare shteti ndikon që mineralet të përpunohen brenda vendit. Nëse minerali eksportohet si lëndë e parë apo koncentrat, vlera e rentës minerare është 4 %, ndërsa nëse mineralet përpunohen brenda vendit, atëherë renta minerare është për 50 % më e ulët. Për qymyrin shihet se kemi një rentë minerare më të ulët nëse përdoret në vend, për 66 % (Mining Royalties, World Bank, James Otto, 2006).

Nga tabela mund të nxjerrim se mesatarja e rentës minerare për metalet bazike është 2.4 %, mesatarja për mineralet industriale është 2.5 %, për arin është 3.2 % dhe për diamantin është 4.7 %.

Nga praktikat ndërkombëtare mund të vërehet se shtetet të cilat e kanë shkallen e lartë të rentës minerare e kanë edhe një monopol në tregun ndërkombëtar të atij minerali.

Nga kjo mund të nxjerrim konkluzionin se ndikimi i rentës minerare në zhvillimin e industrisë minerare është shumë i madh. Me anë të kësaj takse shteti mund t'i orientoj ndërmarrjet për shfrytëzimin e mineraleve të caktuara, mund t'i orientojë ato që të bëjnë përpunimin e tyre në vend etj.

Më poshtë kam paraqitur në formë tabelare krahasimin e rentës minerare në Kosovë dhe mesataren e disa shteteve në botë.

Tabela 1. Mesatarja e tantimës në Kosovë dhe në vendet e tjera

Emri i Shtetit	Përqindja mesatare e rentës minerare
Afganistani	7.50%
Uruguay	5.80%
Burkina Faso	5.70%
Botswana	5.20%
Nigeria	5.00%
Ghana	4.50%
South Africa	4.50%
Turkey	3.10%
Mexico	3.00%
Peru	3.00%
Mauritania	2.80%
Papua New Guinea	2.00%
Kosova	2.00%
Philippines	1.00%
USA	0.80%
Zambia	0.60%
Mali	0.00%
Sweden	0.00%

Nga paraqitja tabelore e krahasimit të rentës minerare në Kosovë dhe në vendet e tjera mund të vërehet se shkalla e rentës minerare aktuale në Kosovë për mineralet kryesore është dukshëm më e ultë se në shumicën e shteteve në botë.

(Baldwin, 2003), kriteret për caktimin e rentës minerare dallojnë nga vendi në vend. Në disa vende bëhet zbritja e shpenzimeve të amortizimit, zbritja e shpenzimeve të transportit nga miniera deri te porti shitës; në disa vende xehja llogaritet në gjendje natyrore, e në disa vende si xehe e terur. Mirëpo, kriter i përbashkët për të gjitha vendet është se baza për llogaritje gjithëherë merret nga sasia e nxjerrë dhe nga çmimi shitës në treg.

Kriteret kryesore për caktimin e shkallës së rentës minerare janë:

- Ndikimi i vendit në tregjet botërore të mineralit të caktuar;
- Kushtet e nxjerrjes së mineralit;
- Shpenzimet për nxjerrjen e mineralit;
- Çmimet e transportit nga miniera deri te porti;
- Çmimet në treg të mineraleve;

- Niveli i kërkesës dhe ofertës në treg për llojin e mineralit;
- Politikat e shtetit për stimulimin e nxjerrjes së një minerali të caktuar;
- Politikat e shtetit për mbrojtjen e një minerali të caktuar;
- Sasia e mineralit të caktuar që posedon vendi;
- Politikat e shtetit për të nxitur përpunimin e një minerali të caktuar në vend;
- Shkalla e ndotjes së ambientit me nxjerrjen e një minerali të caktuar etj.

Për shembull, në Amerikën Veriore kemi tri lloje kryesore të rentës minerare, ajo në “sasinë pas shkrirjes së mineralit”, rentës minerare në “neto profit”, si dhe rentën minerare që caktohet në diamante dhe naftë, mirëpo që ndryshon varësisht nga vendi ku nxirret apo nga origjina e mineralit

Në disa vende, siç janë për shembull Afrika e Jugut, Gana, Mozambiku etj., për disa minerale renta minerare caktohet me marrëveshje në mes të shtetit dhe të kompanisë, e po ashtu caktohen edhe kriteret për mbledhjen e rentës minerare.

Në shumicën e vendeve në botë renta minerare caktohet nga qeveria dhe aprovohet me Rregullore të Udhëzimit të veçantë.

Më shumë informacion në lidhje me rentë minerare nëpër botë dhe shkallën e saj është dhënë në pjesën “Renta minerare në vende të ndryshme të botës”.

Edhe në Kosovë, në Udhëzimin e nxjerrë nga Autoriteti Qendror Fiskal në vitin 2001, janë zbritur shpenzimet e amortizimit dhe shpenzimet e transportit.

Ndërsa tani, në udhëzimin e ri janë bërë disa ndryshime, siç janë: xehja llogaritet në xehen natyrore, nuk zbritet asnjë shpenzim, mirëpo ka zbritje për mineralet që përpunohen brenda vendit, në 20 % nëse shkrihen dhe 50 % nëse përpunohen pas shkrirjes:

Sa i përket aprovimit të shkallës së rentës minerare, në bazë të Ligjit të Minerave dhe Mineraleve (Ligji Nr. 03/L-163, neni 50), tani Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Financave, pas konsultimit dhe marrjes së pikëpamjeve të KPMM-së dhe palëve tjera të interesuara, duke përfshirë bartësit ekzistues të licencave ose përfaqësuesit e tyre, bashkërisht përgatisin dhe nxjerrin një propozim listë të rentës minerare. Pasi që lista të jetë përgatitur nga të dy ministritë përkatëse, ata bashkërisht ia dorëzojnë listën e propozuar Qeverisë për miratimin e saj. Pas miratimit, Qeveria ia dorëzon listën Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.

(Administrative Instruction, 2001), në Kosovë renta minerare aplikohet që nga vitet e pasluftës. Lista e rentës minerare është hartuar për herë të parë në vitin 2001, apo më mirë të thuhet është huazuar modeli australian i llogaritjes së tantimës, grupizimi i mineraleve dhe caktimi i lartësisë së rentës minerare. Përrjashtim nga modeli australian në lartësinë e rentës minerare është bërë për mineralet ndërtimore, duke e caktuar një çmim më të lartë për to, sepse çmimi në tregun e Kosovës për mineralet ndërtimore në atë kohë ka qenë shumë i lartë.

=====

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur lista e mineraleve dhe lartësia e rentës minerare e caktuar për ato minerale. Në vitin 2001, kur është nxjerrë kjo listë, në Kosovë valuta zyrtare ka qenë marka gjermane.

Ky Udhëzim është nxjerrë më 12 korrik 2001, nga Autoriteti Qendror Fiskal dhe Departamenti për Qeverisje Lokale. Në të ka qenë karakteristike se të hyrat nga renta minerare janë mbledhur nga inspektorët komunalë, ndërsa është bërë ndarja e tyre në 50 % për nevojat e komunës dhe 50 % për nevojat e buxhetit qendror.

Me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/3, tantimën ka qenë i obliguar që ta caktojë Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në konsultim me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa. Në vitin 2005 është adaptuar çmimorja nga viti 2001, ndërsa në nëntor të vitit 2006, Bordi Qeverisës i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale ka marrë vendim për rishikimin e tarifës. Një grup punues, ka përgatitur një tarifë të re, e cila i është rekomanduar Bordit të KPMM-së, dhe pas aprovimit nga Bordi, kjo tarifë ka hyrë në fuqi që nga janari i vitit 2007.

Tarifa e re është ndryshuar për mineralet industriale, ndërtimore, gurë të çmuar dhe ujë mineral & termal, ndërsa nuk është ndryshuar për mineralet metalike dhe mineralet energjetike. Ndryshimi i rentës minerare për këto minerale është shtyrë me qëllim që ky propozim të rishikohet edhe njëherë nga qeveria dhe parlamenti, sepse shfrytëzimi i këtyre mineraleve në zhvillimin ekonomik të Kosovës ka një rëndësi të veçantë. Është shumë me rëndësi që kjo tarifë të përputhet me politikat e qeverisë për zhvillimin e minierave, politika të cilat duhet të jenë të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës.

Edhe pse në bazë të Rregullores 2005/3, mandatin për aprovimin e çmimoreve e ka pas Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, megjithatë Komisioni ka marrë vendim për rishikim të këtyre tarifave në bashkëpunim me Qeverinë dhe Parlamentin. Kjo për shkak se është e domosdoshme që në Kosovë të ketë stabilitet dhe pajtueshmëri në mes të institucioneve, meqë investorët e huaj janë shumë të interesuar të ketë stabilitet ligjor në një vend para se të marrin vendim për investimin e parave të tyre. Nëse do të kishim mospajtime në mes të institucioneve në lidhje me lartësinë e tantimës, kjo do të krijonte dyshime tek investorët potencialë se pas bartjes së kompetencave nga ndërkombëtarët te vendorët, apo pas ndërrimit të partive politike në pushtet, mund të ndodhin ndryshime të mëdha të cilat do t'i rrezikonin investimet e tyre.

Tani me Ligjin e Minierave dhe Mineraleve (Ligji Nr. 03/L-163), rentën minerare e propozon Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Financave, në konsultim me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe përfaqësuesit e kompanive të cilët janë bartës të licencave. Ky propozim dërgohet në Qeveri për miratim, ndërsa Kuvendi i Republikës së Kosovës e miraton listën e rentës minerare.

Në tarifën e aprovuar nga Bordi Qeverisës i KPMM-së për Mineralet

=====

Ndërtimore dhe Industriale ka pasur një ulje 50 % të tarifave të tantiemës. Kjo është bërë me qëllim të stimulimit të rritjes së investimeve në këtë sektor, si dhe për shkak të ndërrimit të çmimit të tregut për shitjen e këtyre mineraleve.

Ndryshimi i rentës minerare për mineralet metalike dhe energjetike ka qenë vazhdimisht në proces sipas ndryshimeve në treg. Rekomandimet e para të ekspertëve vendorë ishin që të bëhet dyfishimi i rentës minerare për këto minerale, duke pasur parasysh edhe çmimet e larta të metaleve në bursa. Mirëpo, ka pasur një vonesë në këtë drejtim, sepse domosdoshmërisht renta minerare duhej të përshtatej me Strategjinë e Zhvillimit të Minierave, e cila duhet të përgatitej nga qeveria dhe të aprovohej nga kuvendi. Me këtë strategji do të vendosej nëse do të bëhet stimulimi i nxjerrjes së ndonjë minerali të caktuar dhe nëse do të bëhet stimulimi i përpunimit të xeheve në vend etj.

Domosdoshmëria që çmimi i rentës minerare të ndryshohet u rrit për shkak se çmimet e metaleve aktualisht ishin të larta, ndërsa edhe aktivizimi i minierave në Kosovë është rritur nga viti 2007, kur Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale i ka lëshuar licencë për prodhim ndërmarrjes së Ferronikelit në dy miniera dhe ish-minierave të Trepçës në Stantërg, Artanë, Cernac dhe Belloberdo. Po ashtu ka në përgatitje e sipër edhe minierat e Goleshit, Xim Strezovcit, Drazhnjes etj.

Prandaj, duhet shfrytëzuar këto çmime të larta të metaleve që edhe Buxheti Republikës së Kosovës të përfitojë nga nxjerrja e xeheve në Kosovë.

Është e rëndësishme të përmendet së rishikimi i rentës minerare do të këtë një llogaritje të re dhe më të thjeshtë, pasi në të gjitha mineralet që janë në bursë do të këtë një llogaritje sipas përqindjes.

Përqindja në llogaritjen e rentës minerare nënkupton përqindjen e caktuar që llogaritet nga çmimi në bursë i atij minerali, pra inkasimi i përqindjes bëhet në bruto, sasia e prodhuar shumëzuar me çmimin shitës shumëzuar me përqindjen e caktuar.

Tabela 2. Shembull i llogaritjes së rentës minerare

1	2	3	4	5	6
Përshkrimi i Mineralit	Sasia	Çmimi	Shitja 2 x 3	Përqindja e rentës minerare	Shuma për pagesë 4 x 5
Nikel	1 ton	35,000 €	35,000 €	4%	1,400 €

(Kelmendi, 2006), nga shembulli në tabelë është si në vijim:

$(Q \times P) \times T = \text{Shuma për pagesë}$

$Q = \text{Sasia e mineralit të nxjerrë}$

$P = \text{çmimi i tregut për mineralin e caktuar}$

$T = \text{Përqindja e tantiemës}$

$(100 \text{ t} \times 35,000 \text{ €}) \times 4 \% = 1,400 \text{ €}$

(Republika e Kosovës, 2012), Gjatë viti 2012 Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ambientit dhe ekspertëve të lëmisë minerare, hartuan Strategjinë Minerare afatgjatë e cila i hapi edhe udhën rishikimit dhe ndryshimit të listës së tantiemave në Kosovë, ku më 25 maj 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës aprovoi listën e tantiemave me ndryshimet e propozuara nga institucionet e lartëcekura.

Pra, më 25 maj të vitit 2012 Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 65 par.9, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës mori vendim ta miratojë Propozimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me “Listën për Rentat Minerare”, ku nga kjo datë është në fuqi ajo listë.

Në hartimin e kësaj liste të tarifave për mineralet kanë punuar: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Minisria e Financave (MF), përfaqësues të Trepçës si dhe ekspertë të lëmisë minerare.

Në vijim është e paraqitur lista për tantiemat e aplikueshme në shtetin e Kosovës.

Tabela 3. Lista për Rentat Minerare nga 25 maj 2012

Lista e Rentave Minerare / List of Royalties / Lista Rudarske Rente								
Nr.	Grupi i lëndës minerale// Commodity group/Mineralna grupa	Nëngrupi i lëndës minerale// Commodity subgroup/Podgrupa mineralna	Lënda minerale / Commodity / Vrsta Minerale			Njësia Unit Jedinica	RENTA MINERARE ROYALTIES RUDARSKA RENTA	
			Shqip	English	Serbian		%	(€ / t)
1	Mineralet energjetike / Energy minerals / Energetski minerali	Hidrokarbure të ngurta / Solid hydrocarbons / Cvrsti ugljovodnici	Qymyri (Linjiti)	Coal	Ugalj	t		3.00 €
2	Mineralet metalore Metalic minerals Metalni minerali		Argjenti (Ag)	Silver	Srebro	kg	5.00%	
			Ari (Au)	Gold	Zlato	kg	5.00%	
			Mineralet e platines (Pt)	Platinoid minerals	Minerali Platina	kg	5.00%	
			Platina (Pt)	Platinum	Platina	kg	5.00%	
			Hekuri (Fe)	Iron	Zeljezo	t	4.50%	
			Xehe Hekuri	Iron ore	Ruda Zeljeza	t	4.50%	
			Kromi	Chromium	Hrom	t	4.50%	
			Xehe kromi	Chromite ore	Ruda hroma	t	4.50%	
			Mangan-Mn	Manganese	Mangan	t	4.50%	
			Xehe mangani	Manganese ore	Ruda mangana	t	4.50%	
			Pirit	Pyrite	Pirit	t	4.50%	
			Alumini (Al)	Aluminium-Al	Aluminium	t	4.50%	
			Xehe Boksiti	Bauxite ore	Ruda boksita	t	4.50%	
			Bakri (Cu)	Copper	Bakar	t	4.50%	
			Xehe bakri	Copper ore	Ruda bakra	t	4.50%	
			Xehe bismuti (Bi)	Bismuth ore	Ruda bizmuta	t	4.50%	
			Gali (Ga)	Gallium - Ga	Gallium	t	4.50%	
			Kadmiumi (Cd)	Cadmium	Kadmium	t	4.50%	
			Kobalti (Co)	Cobalt	Kobalt	t	4.50%	
			Nikeli (Ni)	Nickel	Nikal	t	4.50%	
			Xehe Ni-Co	Nickel - Cobalt ore	Ruda Ni-Co	t	4.50%	
			Plumbi (Pb)	Lead	Olovo	t	4.50%	
			Zinku (Zn)	Zinc	Cink	t	4.50%	

			Xehe (Pb-Zn)	(Lead, zinc) ore	Ruda (Pb-Zn)	t	4.50%	
			Antimoni (Sb)	Antimony	Antimon	t	4.50%	
			Xehe Sb	Antimony ore	Ruda (Sn)	t	4.50%	
			Arseni (As)	Arsenic	Arsen	t	4.50%	
			Xehe Kallai	Tin ore	Ruda Kalaja	t	4.50%	
			Zhiva - Hg	Mercury	Ziva	t	4.50%	
			Xehe Hg	Mercury ore	Ruda zive	t	4.50%	
			Xehe molibdeni	Molybdenite	Ruda molibdena	t	4.50%	
			Xehe tungstiti	Tungsten and its ores	Ruda volframa	t	4.50%	
3	Mineralet industrial minerals Industriski mineral	Argjillat Clay / Glina	Argjillë qeramike	Pottery clay	Keramicka glina	t		0.20 €
			Argjillë zjarrduruese	Fire clay	Vatrostalna glina	t		0.20 €
			Argjillë për tullë	Brick clay	Glina za opeke	t		0.13 €
		Mineralet kimike Chemical Minerals Hemiski Mineral	Kuarcit	Quartzite	Kvarcit	t	4.00%	
			Rëra kuarcore	Silica sand	Kvarcni pesak	t	4.00%	
			Diatomit	Diatomite	Diatomit	t	2.00%	
			Tuf - zeolite	Tuff	Zeolit tuf	t		0.60 €
			Bariti	Barytes	Barit	t		0.60 €

		Mineralet teknike Technical Minerals Technicki minerali	Xehe grafiti	Graphite ore	Ruda grafita	t	4.00%	
			Talk	Talc	Talk	t	4.00%	
			Sepiolit	Sepiolite	Sepiolit	t		0.60 €
			Asbesti	Asbestos	Azbest	t	4.00%	
			Bentoniti	Bentonite	Bentonit	t		0.60 €
		Mineralet zjarrduruese dhe për qeramikë / Refractory and ceramic minerals / Vatrostalni I minerali za keramiku	Dunit - industri	Dunite industrial	Industriski Dunit	m ³		0.60 €
			Halluaziti	Halloysite	Halojzit	t		1.20 €
			Kaolinë	Kaolin	Kaolin	t		0.60 €
			Magneziti	Magnesite	Magnezit	t	4.00%	
			Xehe magneziti	Magnesite ore	Ruda Magnezita	t	4.00%	
4	Mineralet ndërtimore / Construction minerals / Gradjevinski minerali	Me minim / With blasting / Miniranjem	Andezit	Andesite	Andezit	m ³		0.50 €
			Bazalt	Basalt	Bazalt	m ³		0.60 €
			Diabaz	Diabase	Diabaz	m ³		0.50 €
			Dunit-ndërtimtari	Dunit construction	Gradjev-Dunit	m ³		0.50 €
			Gabro	Gabbro	Gabro	m ³		0.50 €
			Gëlqeror kompakt-masiv	Limestone massive dense	Kompaktni masivni krečnjak	m ³		0.50 €
			Gneis	Gneiss	Gnajs	m ³		0.50 €
			Granit	Granite	Granit	m ³		0.60 €

			Harzburgit	Harzburgite	Harzburgit	m ³		0.50 €
			Peridotit	Peridotite	Peridotit	m ³		0.50 €
			Piroksenite	Pyroksente	Piroksenit	m ³		0.50 €
			Ranor	Sandstone	Pescar	m ³		0.50 €
			Kuarcitite	Quartzitite	Kvarclatit	m ³		0.60 €
			Mergelë	Marlstone	Lapor	m ³		0.60 €
			Kuarcite	Quartzite	Kvarcit	m ³		0.60 €
		Pa minim / Without Blasting / Bez miniranja	Sienite	Syenite	Sienit	m ³		0.60 €
			Travertinë (Bigor)	Travertine	Travertin (bigar)	m ³		0.60 €
			Gëlqeror shtresor (artizanal)	Limestone platy (Handicraft)	Uslojen Krecnjaci (rucno kopani)	m ³		1.00 €
			Flis	Flysch	Flis	m ³		1.00 €
			Material piroklastik	Pyroclastic material	Piroklasticioni material	m ³		1.00 €
			Rreshpe	Schistoise stone	Skriljci	m ³		1.00 €
			Serpentin	Serpentine	Serpentin	m ³		1.00 €
		Mergelë	Marlstone	Laporac	m ³		0.80 €	
		Materiale të pa lidhura dhe inert /	Mergal për çimento	Marl for cement	Lapor za cement	m ³		1.00 €
		Unlinked and loose materials / Nepovezani slobodan material	Rërë kuarcore-ndërtimtari	Silica sand (construction)	Gradjeviniski kvarcni pesak	m ³		1.00 €
			Depozitime deliviale	Deluvium deposits	Deluvialni sedimenti	m ³		1.00 €
			Rërë dhe zhavorr (Aluvione)	Sand & Gravel (Aluvium)	Aluvialni pesak I sljunak	m ³		1.25 €
			Rërë dhe zhavorr (në lum)	Sand & Gravel (River)	Racni pesak I sljunak	m ³		1.25 €
5	Gurë të çmuar, gjysmë të çmuar dhe dekorativ / Precious and semi-precious stones / Drago polludrago I dekorativni kamen	Gjysmë të çmuar / Semi Precious / Polu drago	Granate	Garnet	Granati	m ³	4.00%	
			Opal	Opal	Opal	kg	4.00%	
			Piroksenite	Pyroksente	Pirokseniti	kg	4.00%	
		Gurë dekorativ / Decorative stone/ Dekorativni kamen	Mermer	Marble	Mermer	m ³	3.20%	
			Konglomerate	Conglomerate	Konglomerati	m ³	3.20%	
			Brekçe	Breccias	Breca	m ³	3.20%	
6	Uji mineral / Mineral Water / Mineralna vode		Uji mineral	Mineral water	Mineralna vode	m ³	2.00%	

NDIKIMI I RENTËS MINERARE NË BUXHETIN E KOSOVËS

Renta minerare si e hyrë publike ka shënuar rritje të vazhdueshme që nga viti kur ka filluar të mbledhet si e hyrë shtetërore në Kosovë.

Përveq rentës minerare, KPMM i mbledh edhe 2 lloje tjera të të hyrave publike të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me rentën minerare, apo aktivitetet rreth saj.

Termi Rentë minerare, ka qenë tradicionalisht i zbatuar në legjislacionin e minierave, kur iu referua specifikes, ad valorem dhe në disa raste, taksave të minierave bazuar në fitimin kontabël.

Në fakt, të gjitha format e përcaktuara më lart janë mënyra alternative për qeveritë, për qiratë duhura ekonomike, unike të minierave dhe janë aplikuar përveç tatimit të përgjithshëm, në të ardhurat e korporatave dhe forma të tjera të taksimit që mbulojnë të gjithë sektorët e ekonomisë (*Pietro, 2012*).

Tabela 4. Të hyrat e realizuara nga renta minerare për vitet 2011-2014 (Raporti Vjetor për vitin 2014)

Nr	Përshkrimi	Inkasimi për vitin 2014	Inkasimi për vitin 2013	Inkasimi për vitin 2012	Inkasimi për vitin 2011
1	Taksat Administrative	280,705.45	392,742	345,885	407,489
2	Gjobat Administrative	147,246.15	168,853	180,496	166,355
3	Renta Minerare	26,538,979.42	24,693,417	5,887,154	7,266,689
Totali		26,966,931	25,255,012	6,413,535	7,840,533




Figura 1. Inkasimi i të hyrave nga renta për vitet 2011-2014

Tabela 5. Përqindja e buxhetit në raport me të hyrat nga renta në KPMM, (Raporti vjetor për vitet 2011-2014).

Vitet	2011	2012	2013	2014
Buxheti i KPMM	1,279,208.86 €	1,262,384.48 €	1,373,100.38 €	1,552,998.13 €
Të hyrat nga renta	7,840,533.00 €	6,413,535.00 €	25,255,012.00 €	26,966,931.02 €
% e buxhetit të KPMM në krahasim me rentën	16.32	19.68	5.44	5.76

Nga tabela e mësipërme shihet se në krahasim me buxhetin të cilin e shpenzon KPMM, të hyrat janë në një nivel shumë më të lartë.

Edhe pse niveli i arkëtimit të të hyrave nga renta minerare, në Kosovë ka shënuar ngritje të madhe, prap se prap, nuk është në nivelin e duhur. Kësaj i kontribuojnë mos pagesa e tantumës nga ana e Minierave në Kosovë, konkretisht “Trepës”, operuesit ilegal si dhe disa faktorë tjerë.

Tabela 6. Përqindja e rentës minerare në raport me buxhetin e Kosovës për vitet 2012-2014 (Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitet 2011-2014)

Vitet	2012	2013	2014
Buxheti i Kosovës	1,508,912,003 €	1,591,118,599 €	1,589,324,952.00 €
Të hyrat nga renta	6,413,535.00 €	25,255,012.00 €	26,966,931.02 €
% e buxhetit të KPMM në krahasim me rentën	0.42	1.58	1.70

2.1.2 NDIKIMI I MINIERAVE (RENTËS) NË ZHVILLIMIN EKONOMIK NË KOSOVË

Sektori minerar luan një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi. Ky sektor ofron mundësi për eksport dhe për përfitime të mëdha, që mund të çojnë në zhvillim ekonomik në afat të shkurtër dhe të krijojmë mundësi për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit.

Me këtë kapitull, do të bëjmë përpjekje t’i vëmë në pah karakteristikat që

=====

rezultojnë në zhvillimin e një vendi, duke pasur për bazë funksionalitetin dhe ndikimin e mirëfilltë të minierave.

2.1.3 Zhvillimi i Industrisë Minerare në Kosovë

Prapambeturia ekonomike e trashëguar nga sundimi feudal turk jo vetëm që nuk u përmirësua, por ajo u keqësua edhe më tej në periudhën në mes të dy luftërave botërore. Situata politike dhe ekonomike e Jugosllavisë së Versajit kushtëzoi edhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Borgjezia e atij shteti sllav nuk ishte aspak e interesuar për zhvillimin e territoreve (viseve) të banuara më pakica kombëtare, andaj zhvillimi i përgjithshëm ekonomik si edhe i lëmenjve ekonomik në veçanti në Kosovë gjate tërë kohës së asaj Jugosllavie u lan pas dore.

Të flasësh për zhvillimin e industrisë në Kosovë në kohën në mes dy luftërave botërore është shumë vështirë, sepse objekte industriale në kuptimin e plotë të fjalës nuk kanë ekzistuar. Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore në Kosovë mund të flasim vetëm për ekzistimin dhe zhvillimin e industrisë nxjerrëse. Sipas resurseve natyrore (xehet dhe mineralet e ndryshme), Kosova ishte shumë herët¹³ e njohur dhe atë jo vetëm në Jugosllavi, por edhe jashtë kufijve të saj.

Në kohën ndërmjet dy luftërave, në Kosovë në kuadër të degëve industriale ishte e zhvilluar industria e ekstrakteve, përkatësisht eksploatimi i xeheve dhe i mineraleve, për ç'gjë ishte e interesuar si borgjezia e vendit ashtu edhe kapitali i huaj. Në kontekst të kësaj mund të cekim së për zhvillimin e industrisë së ekstrakteve në Kosovë rëndësi të posaçme ka depërtimi i kapitalit të huaj. Në atë kohë në Kosovë më të madhe kishte depërtuar kapitali anglez, francez dhe gjerman. Kapitali anglez ishte kryesisht i orientuar në eksploatimin dhe prodhimin e xehes së plumbit dhe të zinkut, kapitali francez ishte avancuar ekskluzivisht në ngritjen e komunikacionit hekurudhor, ndërsa kapitali gjerman në eksploatimin e azbestit.

Politika industriale dhe politika e industrializimit të Jugosllavisë së Versajit 1918-41 më tepër është manifestuar në shikimin pasiv të eksploatimit të begative natyrore të xehetarisë, pylltarisë dhe bujqësisë dhe fuqisë punëtore të Jugosllavisë, në pjesëmarrjen e qeverisë dhe të shtetit në këtë eksploatim, në nxjerrjen e fitimeve individuale, sesa në ndonjë udhëheqje aktive e më plan të industrializimit si rrugë e vetme e ecurive të zhvillimit të popullit. Pra, në këtë kohe nuk kishte ndonjë koncept të zhvillimit të industrisë moderne, as në nivel të Jugosllavisë e mos të flasim për

¹³ Për zanafillën e industrisë në Kosovë mund të flitet në kuptimin historik që nga koha e zbulimit të metaleve. Iliret, banorët më të lashtë të kësaj treve, përpunuan metalet e ndryshme, si për vegla pune, ashtu edhe për armë lufte dhe stoli te ndryshme. (Dr. Tahir Avdyli: Zhvillimi i Industrisë në Kosovë, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1978 fq. 15.)

=====

zhvillimin e industrisë në pikëpamje territoriale. Qëllimi kryesor i sistemit borgjez të Jugosllavisë së vjetër ishte që territoret e banuara më kombe dhe kombësi pa të drejtë kombëtare, ku në veçanti dalloheshin viset e banuara më shqiptarë, të ngelin të pa zhvilluara dhe si të tilla të jenë vise të përshtatshme për plasmanin e kapitalit të huaj, nga të cilat rajone borgjezia e vendit nxori përfitime të mëdha materiale. Kështu, pra ndodhi edhe më territorin e Kosovës, në të cilin borgjezia e vendit orientoi kapitalin e huaj për eksploatimin e begative natyrore të cilat i kishte kjo trevë.

As borgjezia e vendit e as shoqëritë aksionare të huaja që eksploatonin resurset natyrore të Kosovës nuk ishin të interesuara dhe nuk kishin kurrfarë pretendimesh për finalizimin e tyre në këtë treve. Kjo ndikoi që Kosova në pikëpamje të zhvillimit ekonomik të mbetet njëra ndër viset më të pazhvilluara jo vetëm në Jugosllavi por edhe në Evropë (**M. Limani, 1994**).

Për shfrytëzimin e begative natyrore (sidomos xeheve) të Kosovës ndërmjet dy luftërave botërore filloi më të madhe të interesohet kapitali i huaj, në fillim për kërkime gjeologjike e më vonë për eksploatimin dhe prodhimin e drejtpërdrejtë të xeheve. Në fillim për kërkime gjeologjike u investuan 200.000 funta sterlina, e cila vlerë më 1930 arriti shumë prej 328.670 funta sterlina (**Dragan Blagojevic, 1974**). Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, xehetaria e Kosovës kryesisht lihet pronë e kapitalit të huaj. Më 1928, minierat e plumbit dhe të zinkut të Kosovës bëhen pronë e Bashkësisë Ekonomike Angleze ("Selection Trust Limited") nga Londra. Bashkësia Ekonomike Angleze veprimtarinë e vet ekonomike në Jugosllavi e filloi në vitin 1926. Kjo shoqëri aksionare angleze në Kosovë formoi tri miniera të plumbit dhe të zinkut: minierën e "Trepçës" (Trepça Mines Limited), Minierën e "Kopaunikut" (Kopaonik, Mines Limited) dhe minierën e "Novo Berdes" (NovoBrdo, Mines Limited), eksploatimin e të cilave e ka bërë deri më 1938. Më 1929, në minierën e Trepçës në Stan Terg u zbuluan rezervat e xehes së plumbit, xehet e zinkut: 1.750.000 t. me përmbajtje 11,5% plumb, 10,5% zink dhe 8,5% kg.

Prodhimi në minierën e StanTërgut filloi më 1930, me kapacitet prej 500 tonelatash, i cili më 1932 u rrit në 2000 tonelata në ditë. Zbulimi i rezervave të mëdha dhe me përmbajtje të metalit e shtyri kompaninë angleze "Selection Trust Limited" të bëjë hulumtime të mëtejshme dhe të shtojë prodhimin e xehes së plumbit dhe të zinkut. Kështu, më 1938, prodhimtaria e xehes së plumbit dhe e zinkut arriti në 655.892 tonelata.

Krahas shtimit të prodhimtarisë së xehes së plumbit dhe zinkut u rritën edhe kapacitetet e flotacionit në Trepçë. Kështu, më 1930 flotacioni punoi më 500t. xehe, më 1931 u ngrit në 1000 tonelata, më 1932 u ngrit në 397.963 t, më 1937 në 600.00 t, kurse më 1940 punoi 698.700 t. xehe (**Avdyli, 1978**).

=====

Në periudhën e viteve 1930 e deri më 20.04.1940 në Trepçë janë nxjerrë 6.100.271 tonelata xehe e përpunuar, 674.861 tonelata xehe e fisnikëruar dhe 488.908 tonelata koncentrat pirit.

Në Kosovë hulumtimet dhe punimet rreth shfrytëzimit të xehes së kromit kanë filluar në vitin 1925, por deri më 1928 nuk kemi pasur ndonjë prodhim të rëndësishëm. Në periudhën e viteve 1928-1940 në Kosovë u prodhua gjithsej xehe kromi prej 149.890 tonësh. Në sasi të vogla xehja e kromit është prodhuar edhe në Brezovicë (Shtërpçë) dhe në Deve (Gjakovë)

Në periudhën ndërmjet dy luftërave kanë ekzistuar disa fabrika (punëtori) të çimentos. Më e njohura ishte fabrika e çimentos "Lepenac" në Han të Elezit, e cila filloi punën më 1936 me një prodhimtari prej 4415 t. Prodhimtaria e çimentos në këtë fabrikë më 1937 u shtua në 17074 t, në vitin 1938 në 18022 tonë dhe më 1939 arriti në 35000 tonë çimento.

Në kuadër të zhvillimit të industrisë ekstraktive në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore në Kosovë filloi të lajmërohet edhe zhvillimi i energjetikës. Kosova është e pasur me lumenj dhe me thëngjill, në fillim u ngritën hidrocentrale e më vonë termocentrale.

Hidrocentrali i parë në Kosovë u ngrit në lumin Ibër, në vitin 1927 me fuqi prej 350KW orë, e cila kryesisht është përdorur për konsumin e gjerë të amvisërisë në Mitrovicë dhe Vushtrri, ndonëse më vonë, diku prej vitit 1935, sharra "Ibër" dhe fabrika e tullave prej vitit 1936 kanë shfrytëzuar energjinë elektrike nga ky hidrocentral.

Në Rrafshin e Dukagjinit u ngritën disa hidrocentrale. Hidrocentrali i parë në këto pjesë të Kosovës u ngrit më 1929 në Prizren, e më 1935 në Drinin e Bardhë në Radavc. Energjia elektrike nga këto hidrocentrale përdorej kryesisht për konsum të amvisërive të Prizrenit dhe të Pejës.

Në periudhën ndërmjet dy luftërave, pos hidrocentraleve të cekura, në Kosovë u ndërtuan edhe disa termocentrale. Termocentrali i parë në Kosovë u ndërtua në vitin 1930 në Zveçan, me fuqi prej 100KW orë, që shërbente për nevoja të reparteve të "Trepçës". Për nevoja të amvisërive termocentrale të vogla u ndërtuan në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë. Prodhimi i tërësishëm i energjisë elektrike në këtë kohë përdorej kryesisht për konsum për amvisëritë e qendrave më të mëdha urbane të Kosovës, e shumë pak për nevoja industriale. Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike më 1939 ishte gjithsej 36.954.000 kilovat-orë, përkatësisht 58 KV-orë për një banor. Nga prodhimi i përgjithshëm i elektroenergjisë 92,8% prodhonte termoelektrana e xeherores Trepça.

Hulumtimet për thëngjill në Kosovë kanë zanafillën më 1920. Prodhimi i thëngjillit në Kosovë ka filluar në vitin 1922 në minierën "Kosova" afër Obiliqit, përkatësisht Prishtinës. Në periudhën e viteve 1922-1940 në Kosovë janë prodhuar

=====

gjithsej 783.325 t. thëngjill.

Ndikimi i Minierave në Zhvillimin Ekonomik

Sektori minerar luan rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit në tërësi. Synim i kësaj teme është vlerësimi dhe kuantifikimi i përfitimeve të krijuara nga industria minerare për ekonominë e vendit në tërësi, duke marrë parasysh pengesat, kufizimet teknike, zhvillimet në tregun ndërkombëtar të resurseve minerale, si dhe karakteristikat e vendburimeve minerale. Sektori i minierave paraqet mundësi për eksport dhe për përfitime të mëdha, e sidomos në rast të privatizimit të shpejt mund të përdoret për të përkrahur ngritjen e zhvillimit ekonomik në një afat të shkurtër. Në vitet e 90-ta industria është zvogëluar si rezultat i neglizhencës dhe mungesës së investimeve kapitale.

Investimi në sektorin e energjisë dhe minierave do të japë rezultate në një afat të mesëm (pesë deri në dhjetë vite), mirëpo edhe investimi në këtë sektor përfshin disa sfida:

- Investime të mëdha nevojiten për të ringjallur sektorin e minierave.
- Investimet nga jashtë janë të një rëndësie të veçantë.
- Duhet kushtuar një rëndësi të veçantë kushteve të nevojshme për tërheqje të investitorëve të jashtëm.

Me qëllim të rimëkëmbjes së këtij sektori me interes për zhvillimin ekonomik të vendit duhet të orientohen investimet kryesisht në këto drejtime.

- Infrastrukturën e minierës (kryesisht infrastrukturë, depo, banimi, zyre, menaxhimi i ujërave dhe hulumtimet afatgjate etj.),
- Pajisje (bartja e dheut, shfrytëzimi, bluarje, flotimi etj.) dhe
- Mjedisore (impianetet e trajtimit të ujit, deponitë e mbetjeve, monitorimi etj.)

Mbështetja e zhvillimit ekonomik kryesisht vetëm në minerale nuk është një strategji e mirë, sepse çmimet e artikujve të përdorimit të gjerë janë të paqëndrueshëm dhe në rastin e mineraleve trendi afatgjatë është në zvogëlim e sipër.

Një ngritje ose stimulim i shpejtë i zhvillimit ekonomik do të vijë nga procesi i privatizimit. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërorë do të ndihmojë në shpëtimin e bërthamave industriale që kanë një potencial të vërtetë ekonomik. Procesi i privatizimit gjithashtu mund të ndikojë dhe ka për qëllim tërheqjen e investimeve direkte nga jashtë, jo vetëm për shkak të teknologjisë superiore dhe shkathtësive menaxhuese që vijnë me të, por edhe si shenjë e një ambienti të mirë të punës për investitorët e tjerë të interesuar.

Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e minierave

Si në çdo organizatë tjetër, ashtu edhe në organizatat minerare ndikojnë një numër i madh i faktorëve të cilët në rastet më të shpeshta i grupojmë në faktorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Faktorët e brendshëm kanë të bëjnë me kulturën dhe klimën organizative brenda organizatës (minierës). Këta faktorë ndikojnë në llojin e strukturës organizative, natyrën e organizatës të shprehur përmes filozofisë menaxheriale, objektivave dhe madhësisë së vet organizatës, teknologjisë dhe teknikave dhe ndikimin e tyre në kryerjen e punëve, natyrën dhe llojin e njerëzve të punësuar në organizata dhe nivelit në organizatë (Kuka, 2006). Ndërsa faktorët në mjedisin e jashtëm kanë të bëjnë me organizatën si sistem i hapur.

Faktorët e mjedisit të brendshëm

Në grupin e faktorëve në mjedisin e brendshëm (**L. Mullins, 2004**) bëjnë pjesë:

- Njerëzit
- Aktivitetet
- Nivelet në organizatë
- Natyra e organizatës
- Struktura organizative
- Teknologjia dhe metodat

Njerëzit, faktori njeri është një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në zhvillimin e çdo organizate. Varësisht prej mënyrës së qasjes dhe ndikimit të njerëzve brenda organizatës mund të vjen deri te zhvillimi apo moszhvillimi i një organizatë. Faktori njeri ndikon në krijimin e kulturës dhe klimën organizative, apo në mënyrën se si gjërat bëhen në organizatë.

Aktivitetet, Renditja e aktiviteteve dhe menaxhimi i tyre në organizatë gjithashtu luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e organizatës. Menaxhimi i keq dhe mosrenditja e aktiviteteve do të ndikojnë negativisht në tërë procesin e punës brenda organizatës dhe si rezultat i kësaj do të vinte deri te mospërfitim i autputit të pritur.

Nivelet në organizatë, Definimi i qartë i niveleve udhëheqëse duke filluar nga ato më të ulëta e deri te nivelet më të larta, do t'i ndihmojë organizatës në renditjen dhe kryerjen me sukses të të gjitha aktiviteteve që dalin nga procesi i

=====

punëve. Me definimin (krijimin) e niveleve në organizatë do të jetë më lehtë të vijë edhe deri te identifikimi i shkaqeve dhe pasojave në rast të moskryerjes së ndonjë aktiviteti apo ngecjes së procesit të punës.

Natyra e organizatës, Organizata varësisht prej natyrës së vet dhe llojit të veprimtarisë që ushtron mund të ketë ngecje apo zhvillim, për nga lloji i veprimtarisë mund të jenë organizata prodhuese, shërbyese, furnizuese apo edhe të kombinuara.

Struktura organizative, Pas definimit të natyrës dhe llojit të veprimtarisë organizata duhet të bëjë krijimin e strukturës organizative brenda ndërmarrjes, mbi bazën e kësaj strukture organizata do të krijojë edhe të gjitha nivelet udhëheqëse në organizatë.

Teknologjia dhe metodat, Në ditët e sotme organizata e mëdha të cilat synim të vetin kanë daljen në tregjet ndërkombëtare kujdes të veçantë janë duke i kushtuar ngritjes së kapaciteteve teknike dhe metodave të punës, si dhe ndikimin e tyre në kryerjen e punëve. Pra, zhvillimi i një organizate në ditët e sotme nuk mundë të paramendohet pa investim në teknologjinë informative dhe përdorimin e metodave efikase për punë të suksesshëm.

Faktorët e mjedisit të jashtëm

Si në çdo organizatë tjetër ashtu edhe në organizatat minerare ndikojnë një numër i caktuar i faktorëve, **(Kuka. J. Pula, 2006)**, në zhvillimin e këtyre organizatave:

- Ekonomik
- Teknologjik
- Politik
- Socialë dhe
- Ndërkombëtarë




Figura 2. Ndikim i faktorëve të jashtëm në organizatë

Faktorët ekonomikë kanë të bëjnë më natyrën dhe drejtimin e ekonomisë ku organizata zhvillon aktivitetin e saj¹⁴. Në kuadër të këtyre faktorëve do të veçojmë.

- **Rritja e ekonomisë** nënkupton madhësinë e kërkesës për mallra dhe shërbime, në këtë periudhë vije deri te zhvillimi i bizneseve dhe ulja e papunësisë.
- **Interesi i ulët**, konsumatorët të gatshëm për të marrë kredi.
- **Inflacioni i lartë**, ndërmarrjet fillojnë të paguajnë më shumë për materiale, shërbime e mirëmbajtje, paraja zhvlerësohet dhe kompanitë fillojnë të dobësohen.
- **Papunësia** do të ndikojë në nivelin e pagës që do të ofrojnë organizatat, në të kundërtën papunësia ulët, oferta do të pësojë rënie dhe punonjësit e kualifikuar do të kenë përparësinë që t’iu kërkojnë paga më të larta kompanive që janë të interesuar për ta.

Faktorët politikë në të shumtën e rasteve i gjejmë si faktorë politiko-ligjor. Këta faktorë përcaktojnë kuadrin, qeverinë dhe ligjet. Qeveria ndërhyr në jetën ekonomike, formon legjislacionin, nxjerr ligje sidomos në fushën e taksave dhe politikës fiskale, ushtron një ndikim mjaft të madh jo vetëm në sferën e biznesit por edhe në aktivitete tjera të jetës shoqërore.

¹⁴ V. Kume, *Menaxhimi Strategjik*. Tiranë 2003, faqe 96

=====

Shkalla e stabilitetit ekonomik të vendit luan rol të veçantë në zhvillimin e sektorit dhe është faktor vendimmarrës në tërheqjen e investitorëve jo vetëm të vendit por edhe të huaj. Gjithashtu në vendin tonë statusi i pazgjidhur deri më tani ka luajtur rol negativ në zhvillimin e minierave.

Faktorët teknologjikë nënkuptojnë pasqyrimin e njohurive aktuale të prodhimit, produkteve dhe shërbimeve. Impakti i teknologjisë reflektohet në produkte të reja, pajisje bashkëkohore dhe shërbime moderne. Përfitimet nga teknologjia janë të shumta ndikojnë në standardin jetësorë, më shumë kohë të lirë dhe intelektualë, alternativa të mundshme në produkte dhe shërbime.

Faktorët socialë kanë të bëjnë më zakonet, qëndrimet dhe sjelljet që janë karakteristikë e një grupi njerëzish apo edhe të një shoqërie të caktuar. Faktorët e këtij mjedisi ndikojnë në zhvillimin e një biznesi P.sh. dallohen zonat e njerëzve të arsimuar apo të paarsimuar, më standarde apo pa standarde, grup mosha etj.

Faktorët ndërkombëtarë, këta faktorë janë më rëndësi sidomos kur është fjala për kompanitë multinacionale. Në këtë grup hyjnë faktorët ekonomikë, politikë, socialë. ndërrimi i qeverisë, kursi i valutave, stabiliteti ekonomik, tregu etj.

PËRFUNDIMI

Duke u mbështetur në ato që u thanë më lart, mund të vijmë në përfundim se investimi në sektorin e energjisë dhe minierave mund të japë rezultate të mëdha në zhvillimin ekonomik të një vendi. Mirëpo, në këtë kontekst duhet pasur parasysh edhe sfidat me të cilat përballlet ky sektor dhe investimet në të. Investimet do të duhej të orientohen kryesisht në infrastrukturën e minierave, në pajisje, dhe në mjedis, ndërkaq për zhvillimin e organizatave minerare ndikojnë faktorë të ndryshëm, të cilët zakonisht ndahen në faktorët të brendshëm dhe të jashtëm. Po ashtu, ndër faktorë tjerë që ndikojnë në zhvillimin e organizatave minerare janë edhe faktorët ekonomikë, politikë, teknologjikë, socialë dhe ndërkombëtarë.

Secili prej këtyre faktorëve ka rolin dhe rëndësinë e vet në zhvillimin e minierave, ndërsa një koordinim i mirë ndërmjet përbërësve të tyre patjetër se do të çojë në zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi.

Si rezultat i proceseve të ndryshme gjeologjike Kosova është e pasur me resurse minerale, nga të cilat resurset minerale energjetike dhe të metaleve më ngjyrë paraqesin potencial të rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit. Si vendburime më të rëndësishme mund të veçohen vendburimet e: qymyrit, plumbit-zinkut (të bashkëshoqëruara më Au dhe Ag), Ni-Co, Fe-Ni, boksitit, manganit etj. Kosova po ashtu është e pasur dhe më një numër të konsiderueshëm të vendburimeve jo-metalore, industriale por edhe ujin mineral e termal si dhe burimet

=====

e energjisë gjeotermale. Shfrytëzimi racional dhe i menaxhuar mirë i këtyre resurseve është bazë për një zhvillim më të shpejtë e të qëndrueshëm ekonomik e social. Resurset minerale janë pasuri e rëndësishme kombëtare, nxjerrja dhe shfrytëzimi i tyre paraqet një kontribut thelbësor për ekonominë në Kosovë. Në zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit dhe njëkohësisht dhe në ruajtjen e pasurive natyrore të jo ripërtriteshme do të kontribuonte dhe shfrytëzimi i resurseve të ripërtritëshme; resurset ujore, energjisë së erës, energjisë diellore, po ashtu dhe materialet e riciklueshme mund të plotësojnë një pjesë të kërkesave.

Bazuar në studimet gjeologjike të kryera nga ndërmarrjet të cilat kanë qenë apo janë të licencuara për shfrytëzim të resurseve minerale ndërtimore dhe industriale, gjendja e rezervave të vërtetuara më studime gjeologjike dhe njëkohësisht gjendja e tanishme e rezervave të gatshme për shfrytëzim është paraqit në tabelën e mëposhtme.

Andaj si rezultat i kësaj Kosova ka potenciale të mëdha në mbledhjen e rentës minerare si e hyrë publike, e cila do të ndikonte shumë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Me përjashtim të rentave minerare, të hyrat e mbledhura nga KPMM në formë të taksave të licencave dhe tarifave tjera të mbledhura në përputhje me ligjin janë “të hyra të dedikuara” të KPMM-së. Fondet e donatorëve të siguruara veçanërisht për mbështetjen e KPMM-së po ashtu konsiderohen si “të hyra të dedikuara” të KPMM-së. Të gjitha këto mjete do të depozitohen në buxhetin e Republikës së Kosovës dhe do të ndahen për qëllimet e autorizuar të KPMM-së në bazë të kategorisë përkatëse buxhetore dhe në përputhje me procesin buxhetor të themeluar nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Rentat minerare të mbledhura nga KPMM nuk janë “të hyra të dedikuara” të KPMM-së por janë hyra të përgjithshme të Republikës së Kosovës. Rentat minerare do të derdhen si të tilla në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Të gjitha rentat minerare, taksat dhe pagesat e tjera që i janë paguar ose që janë pranuar nga një autoritet publik në Kosovë sipas këtij legjislacionit, shndërrohen në “para publike” sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe do të trajtohen në përputhje me dispozitat e atij ligji.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Financave, pas konsultimit dhe marrjes së pikëpamjeve të KPMM-së dhe palëve tjera të interesuara, duke përfshirë bartësit ekzistues të Licencave ose përfaqësuesit e tyre, bashkërisht përgatisin dhe nxjerrin një propozim listë të rentave minerare që bartësit e Licencave duhet t’i paguajnë për ushtrimin e aktiviteteve të licencuara të shfrytëzimit të resurseve minerale në Kosovë. Propozim-lista në fjalë, do të përcaktojë në hollësi formulat që duhet shfrytëzuar për llogaritjen e shumës së rentave minerare. Pasi që lista të jetë përgatitur nga dy ministritë përkatëse, ato bashkërisht i’a dorëzojnë

listën e propozuar Qeverisë për miratimin e saj. Pas miratimit, Qeveria i'a dorëzon listën për aprovim Kuvendit.

Shteti, me anë të rentës minerare, përveç që krijon të hyra mund të bëjë edhe orientimin e investimeve në shfrytëzimin e mineraleve të caktuara. Po ashtu, ka mundësi që të orientojë përpunimin e mineraleve në vend, apo shitjen e tyre në formë të koncentrateve. Meqenëse resurset që shfrytëzohen janë në brendi të komunave, dhe komunat ballafaqohen direkt me pasojat e ndotjes së ambientit, ekziston mundësia e shpërndarjes së të hyrave nga renta minerare nëpër komunat në të cilat veprojnë kompanitë minerale, dhe komunat të investojnë për zhvillimin e projekteve të tyre dhe projekteve të tjera sociale për ndihmë komunitetit.

Me anë të rentës minerare mund të stimulohen edhe shfrytëzimet e mineraleve të caktuara. Për shembull, në Kosovë, në bazë të disa studimeve dhe analizave, është konstatuar së “guri i fortë” nga shkëmbinjtë gëlqerorë është më kualitativ për përdorim në ndërtimtari sesa rëra e cila nxirret nga lumenjtë. Me planin e Guroreve të Kosovës, të punuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është vërtetuar së Kosova ka rezerva të mjaftueshme të gurit gëlqeror, ndërsa në anën tjetër ka dalë kërkesa nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të mbrohen lumenjtë nga shfrytëzimi i rërës. Për shkak se po bëhet degradimi i shtratit të lumenjve, është vendosur që renta minerare për “Rërë dhe Zhavorr” të jetë 150 % më e lartë sesa renta minerare për shfrytëzim të “Gurit Gëlqeror”.

Duhet përmendur se në shumicën e vendeve të botës renta minerare nuk llogaritet si e vetme, apo e ndarë nga taksat e tjera. Për të kalkuluar rentën minerare qeveritë kanë parasysh edhe të gjitha taksat e tjera, duke filluar nga përfitimet e pronarit të tokës, përfitimet e komunitetit, tatimin në fitim etj.

Në shembullin e mëposhtëm të paraqitur në formë grafike mund të vërehet pjesëmarrja e të gjitha palëve në profitin e një miniere.




Figura 3. Ndarja e rentës minerare (të hyrave nga miniera) ¹⁵

¹⁵ James Otto, “Mining Royalties”, The World Bank, SHBA, 2006

KONSTATIME DHE DISKUTIME

Konstatimet

Në bazë të hulumtimeve gjatë përgatitjes së këtij punimi si konstatime apo të gjetura të mia, mund t'i cekim si në vijim:

1. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është organi kompetent dhe përgjegjës për arkëtimin e rentës minerare në Republikën e Kosovës, si dhe menaxhimin e sektorit minerar.

2. Mos interesimi në nivelin e duhur i Qeverisë së Kosovës për të investuar dhe futur në funksion të duhur Trepçën e cila vërtet është një gjigant i nxjerrjes dhe përpunimit të xeheve, si dhe një mekanizëm ekonomik shumë i fuqishëm i zhvillimit ekonomik të vendit. Pothuajse qeveria nuk është duke bërë asgjë në lidhje me investimin dhe hartimin e politikave për ringjalljen e kësaj ndërmarrje tejet profitabile.

3. Renta Minerare, është një taksë e cila mbledhet nga shfrytëzimi i resurseve minerare. Kjo e hyrë publike në Kosovë nuk është duke u inkasuar në nivelin e kënaqësëm. Arsye për këtë janë operuesit ilegal të cilët i shfrytëzojnë këto resurse dhe nuk paguajnë taksë si dhe mungesa e politikave të qeverisë për zhvillimin e këtij sektori. Renta minerare po ashtu luan rol kyç në tërheqjen e investimeve në sektorin minerar, përmes uljes së çmimit të rentës minerare, kompanitë e mëdha mund të joshen dhe kapitalin e tyre ta investojnë në sektorin e minierave në Kosovë. Çmimi i rentës minerare duhet të caktohet para se kompanitë e mëdha të investojnë në këtë sektor, po ashtu për mineralet në interes të shtetit mund të bëhet edhe mbrojtja e tyre përmes ngritjes së çmimit të rentës minerare. Pra, sektori minerar është një sektor shumë fitim prurës për shtetin dhe zhvillimin ekonomik e social të vendit.

4. Nga niveli i mbledhjes së të hyrave nga renta minerare, shihet se nuk është në nivelin e kënaqësëm. Arkëtimi më i madh dhe shumë i domosdoshëm e i rëndësishëm i rentës minerare në vendin tonë do të ishte nga shfrytëzimi i minierës së Trepçës me të gjitha vendburimet apo degët e saj. Kjo minierë ka rezerva të mëdha të mineraleve të çmuara si Ari, Plumbi, Zinku dhe Argjendi.

Historia tregon se "Trepça" është njëri nga prodhuesit më të mëdhenjë të Plumbit dhe Zinkut në Evropë¹⁶. Më e vjetër se 2000 vjet ky gjigant ekonomik mban mend ilirët, romakët, sllavët, turqit, austro-hungarezët, anglezët, gjermanët e më në fund prap ilirët (pasardhësit e tyre shqiptarët). Që në kohërat e lashta është ditur për vendburimet polimetalore të sulfureve të Pb, Zn, Ag dhe Au, në Kosovë. Disa nga

¹⁶ Ferat Shala, Sala Shala-Berisha, Bislim Muqa, "Trepça – Ristrukturimi, Sfidat dhe Perspektiva", Prishtinë, 2014

=====

vendburimet sulfure të këtij lloji edhe sot pas luftës sv fundit në Kosovë (1998/1999), janë në shfrytëzim si: miniera "Trepça" në Stantërg, në Belloberdë, Cërnac dhe Përroi i Ngjyrosur-Artanë, të cilat gjenden në kuadër të kompleksit "Trepça". Ndërkaq, vendburimet si: Hajvalia, Badovci dhe Kishnica janë të zhytura në ujë dhe kanë mbetur pa kurrfarë mbikëqyrjeje edhe pse para luftës në Kosovë, ato ishin prodhues të rëndësishëm të xehes së plumbit, zinkut dhe argjendit etj. Nga kjo shihet që renta minerare në Kosovë do të ishte mjaft e lartë dhe shumë e rëndësishme dhe duhet t'i kushtohet shumë angazhim nga ana e qeverisë së Kosovës.

Kombinati "Trepça" në tërë periudhën e pas Luftës Dytë Botërore ishte bartës i zhvillimit, prodhimit dhe përpunimit të plumbit dhe zinkut.

Vlera e përgjithshme e prodhimeve (sipas çmimeve mesatare në bursën e Londrës për vitin 1991) shprehur në dollar amerikan (USD), ishte 262, 282,000 USD, shkalla e akumulimit 3.8 %, nga të hyrat e përgjithshme ose në vlerë 10,000,000 USD. Eksporti mesatar vjetor i realizuar ishte 75,000,000 USD.

Nga këto informata shihet se sa është e rëndësishme "Trepça" në ndikimin e rentës minerare dhe zhvillimin ekonomik e social të shtetit tonë.

Shitja e xeheve si koncentrat nga ana e minierës Trepçës, është një humbje e madhe financiare, e kjo si rezultat i mos funksionit të shkrites, ri-ndërtimi i të cilës ka një kosto shumë të madhe.

4.1 . Rekomandimet (diskutimet)

Gjatë hartimit dhe analizimit të këtij punimi i kem nxjerrur disa rekomandime apo diskutime, që sipas mendimit ton janë:

1. Duke u bazuar në rëndësinë e Ndërmarrjes "Trepça" dhe ndikimin e saj në rentën minerare, institucionet e Kosovës duhet të punojë edhe më shumë në promovimin e pasurive minerare të Kosovës, nëpër vende të ndryshme jashtë Kosovës, dhe t'i nxisë investitorët e huaj për investime në sektorin minerar.

2. Qeveria e Kosovës duhet ti kushtojë më shumë rëndësi zhvillimit të sektorit minerar, me hartimin e politikave dhe strategjive afatgjata. Po ashtu duhet të bëjë lehtësira ndaj investitorëve të mëdhenj dhe serioz, në mënyrë që t'i nxisë të inestojnë në Kosovë. Gjëja më e rëndësishme në këtë drejtim, për qeverinë duhet të ishte ringjallja e gjigandit ekonomik "Trepça", e cila është një pasuri shumë e madhe. Poashtu qeveria duhet të ushtrojë kontroll dhe masa të rrepta edhe ndaj disa kompanive të mëdha të cilat duhet të paguajnë një shumë të konsiderueshme të parave në buxhetin e shtetit si : Korporata Elektroenergjetike e Kosovës (KEK), New CO Ferronikeli, fabrika e çimentos SHARR - CEM etj. Pra, sektori minerar në Kosovë duhet trajtuar si sektor primar dhe shumë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik e social të vendit.

3. Një formë e mirë e ringjalljes së sektorit minerar në Kosovë, është Ristrukturimi i minierave në Kosovë. Po ashtu një element tejet i rëndësishëm në

=====

këtë aspekt është edhe ri-ndërtimi i shkrites së xeheve, për klasifikimin dhe pastrimin e xeheve, e jo të shiten si koncentrate siq po ndodh momentalisht nga "Trepça"

4. Pasi që krijimi natyror i mineraleve apo xeheve kërkon një afat të gjatë kohor, atëherë është shumë e domosdoshme shfrytëzimi sa më racional i tyre. Në këtë aspekt do të kishte ndikim të madh hartimi i një strategjie minerare, promovimi i sektorit minerar në botë, ri-ndërtimi i shkrites së xeheve, si dhe futja në listën e paguesve të rentës minerare edhe të gjigandit "Trepça". Po ashtu bashkëpunimi i institucioneve relevante pjesmarrëse në sektorin minerar dhe financiar, do të kishte ndikim të madh në nivelin e rentës minerare.

Bibliography

- Prof.Dr. Sabahudin Komoni – "FINANCAT PUBLIKE", Prishtinë 2008, ISBN: 978-9951-00-072-7 ;
- Prof.Dr. Ali Jakupi – "METODOLOGJIA E PUNES SHKENCORE KERKIMORE", Prishtinë 2005 ;
- J. Anderson, Publik Finance, Principles and Policy, 2003;
- Robert W.Ingram, Thomas Albright and Bruce A.Baldwin – "FINANCIAL ACCOUNTING"
- M. Limani, Politika Ekonomike, Prishtinë (1994);
- Beak Consultants GmbH, Kosovo Resources Management Plan ;
- Georg T.Friedlab – "ESSENTIALS OF FINACIAL ANALYSIS", ISBN: 978-0-471-22830-1;
- I. Kuka. J. Pula. B. Krasniqi, "Menaxhmenti dhe Vendosja", Prishtinë, 2006;
- V. Kume, "Menaxhimi Strategjik" Tiranë, 2003;
- L. Mullins, "Management and Organizational Behaviour", 7 th edition, 2004;
- Ferat Shala, Sala Shala-Berisha, Bislim Muqa, "Trepça – Ristrukturimi, Sfidat dhe Perspektiva", Prishtinë, 2014;
- Dr. T. Avdyli: Zhvillimi i Industrisë në Kosovë, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1978;
- Pietro GUJ, "Mineral royalties and other mining-specifix taxes", Australia, 2012;
- James Otto, "Mining Royalties", The World Bank, SHBA, 2006'
- Sh. Kelmendi, "Metodat matematikore në Inxhinieri", Universiteti i Prishtinës, (Mitrovicë, 2006).
- Baldwin, C. G. (2003). Understanding Royalty Structures. *Working Paper, Canada* , 12.
- Baunsgaard, & Otto. (2001). A Primer on Mineral Taxation. *IMF Working Papaer WP/01/139, International Monetary Found* .
- Instruction, A. (2001). *Central Fiscal Authority*.
- Kelmendi, S. (2006). Metodat Matmatikore në Inxhieneri.

- =====
- Kosoves, R. e. (2012). *Lista e Rentave Minerare*. Nr.04-V-380.
 - Laporte, B., & Quatrebarbes, C. d. (2008). "What do we know about the sharing of mineral resource rent in Afrika?". *Fondation pour les études et recherches sur le développement international* .
 - Otto, J. (2006). *Mining Royalties*. World Bank.
 - Otto, J., Craig, A., Fred, C., Doggett, M., & Pietro, G. (2006). Royalties a global study of their impact on investors, government and civil society. .
 - UMNİK. (2005). Rregullorja e UMNİK-ut. 2005/3, Neni 64.
 - URJ, D. i. (2003). Tantiemat dhe Statistika Minerare në URJ.
 - Ligji për Miniera dhe Minerale Nr. 03/L-163;
 - LIGJI PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE DHE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË, NR. 03/L-048;
 - Ministria e Financave – Thesari i Kosovës – “RREGULLA 03/2010 PËR TË HYRAT”;
 - Ministria e Financave – Thesari – “MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI”, botim në prill 2011, në bashkëpunim me Komisionin Evropian ;
 - Rregullorja e UMNİK-ut 2005/2, për Themelimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (2005);
 - Rregullorja e UMNİK-ut 2005/3 për Minierat dhe Mineralet, 2005;
 - Vendimi për aprovimin e Listës për Rentat Minerare, Nr.04 – V – 380, Prishtinë, 28.05.2012;
 - Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF, Për Paratë Publike, MF, Thesari;
 - “Legjislacioni Tatimor i Kosovës”, Administrata Tatimore e Kosovës, Botimi II, Mars 2011, Prishtinë ;
 - Raporti Vjetor i KPMM-së për vitin 2011, Prishtinë, 2012
 - Raporti Vjetor i KPMM-së për vitin 2012, Prishtinë, 2013
 - Raporti Vjetor i KPMM-së për vitin 2013, Prishtinë, 2014
 - Raporti Vjetor i KPMM-së për vitin 2014, Prishtinë, 2015
 - “CFA Administrative Instruction No. 2001/2”, Autoriteti Qendror Fiskal dhe Departamenti për Qeverisje Lokale, Prishtinë, 12 Korrik 2001
 - Qymyri i Rafinuar, Prof. dr. Bajram Shabani, 2008
 - Royalties A Global Study of Their Impact on Investors, Government, and Civil Society, James Otto, Craig Andrews, Fred Cawood, Michael Doggett, Pietro Guj, World Bank, 2006
 - Mining Royalties, World Bank, James Otto, 2006
 - Kosovo Quarry Plan, BEAK Consultants, (Prishtinë 2006)
 - Understanding Royalty Structures, by Christopher G. Baldwin, Lawson Lundell, Canada, 2003



PENTZA

Jornal for Development Research and Science
Revistë për kërkime zhvillimore dhe shkencë

ISSN 2337-0548 (Print)
ISSN 2337-0634 (Online)
Vol 1, Issue 1, April
- - - -

=====